



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.417/19 prot.

Datë 09.05.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 472/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.05.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. **376/2024**, datë 18.04.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91482-12-18-2023, me objekt: “Vleresim i pergjithshem mbi Sigurine Kibernetike dhe kryerjen e testimeve mbi Infrastrukturen dhe Platformat Teknologjike”, me fond limit 106,833,333 (Njeqind e gjashte milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 1,033,504 (Një milion e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e katër) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All), zhvilluar me datë 24-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “4IG PLC”, me NIPT HU12011069, me adresë: Krisztina korut 39, Budapest, Hungari, Kodi postar 1013

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., me adresë: Blv “Gj. Fishta”, Nd.Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 18.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.376/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “4IG PLC” LTD për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91482-12-18-2023, me objekt: “Vlerësim i përgjithshëm mbi Sigurinë Kibernetike dhe kryerjen e testeve mbi Infrastrukturen dhe Platformat Teknologjike”, me fond limit 106,833,333 (Njëqind e gjashtë milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 1,033,504 (Një milion e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e kater) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmimit të B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All), zhvilluar me datë 24-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE “4IG PLC” & Invitech ICT Services” LTD, sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4IG PLC”.*
- 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr.3457/2 prot., datë 02.05.2024, protokolluar me tonën nr. 417/15 prot., datë 07.05.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 376/2024 datë 18.04.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe urdhrin për heqjen nga anulimi të procedurës me objekt “Vlerësim i përgjithshëm mbi sigurinë kibernetike dhe kryerjen e testeve mbi Infrastrukturën dhe Platformat Teknologjike dhe rivlerësimin e kësaj procedure”.

I.3. Me shkresën nr. 3457/3 prot., datë 08.05.2024 me lëndë “Informacion mbi zbatimin e vendimit nr. 376/2024, datë 18.04.2024”, protokolluar me tonën me nr. 417/16 prot., datë 09.05.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 376/2024 datë 18.04.2024, duke i bashkëngjitur shkresës urdhrin me nr. 3457/1 prot., datë 25.04.2024, kërkesën për sqarim, kthim përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga 4IG plc, informacion nr. 3457/2 prot., datë 02.05.2024.

## II

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr. 3457/3 prot., datë 08.05.2024 me lëndë “Informacion mbi zbatimin e vendimit nr. 376/2024, datë 18.04.2024”, protokolluar me tonën me nr. 417/16 prot., datë 09.05.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 376/2024 datë 18.04.2024, duke i bashkëngjitur shkresës urdhrin me nr. 3457/1 prot., datë 25.04.2024, kërkesën për sqarim, kthim përgjigjen dhe dokumentacionin e dërguar nga 4IG plc, informacion nr. 3457/2 prot., datë 02.05.2024.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.376/2024 datë 18.04.2024.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a e ka zbatuar vendimin Nr.376/2024 datë 18.04.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91482-12-18-2023, me objekt: “Vleresim i përgjithshëm mbi Sigurine Kibernetike dhe kryerjen e testeve mbi Infrastrukturen dhe Platformat Teknologjike”, me fond limit 106,833,333 (Njeqind e gjashte milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 1,033,504 (Një milion e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e katër) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All), zhvilluar me datë 24-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91482-12-18-2023, me objekt: “Vleresim i përgjithshëm mbi Sigurine Kibernetike dhe kryerjen e testeve mbi Infrastruktura dhe Platformat Teknologjike”, me fond limit 106,833,333 (Njëqind e gjashtë milion e teteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH ose 1,033,504 (Një milion e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e katër) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH date 18.12.2023 ku 1 euro = 103.37 All), zhvilluar me datë 24-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.
  2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

